



PRISHTINA



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË  
CJP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA  
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

**Sqarim ndaj artikullit: "Stacioni i Autobusëve në Prishtinë për shkak të pandemisë humbi gjysmë milion euro", i publikuar në portalet: KOHA.NET, KosovaPress dhe Periskop dhe mediat tjera.**

Të nderuar,

Deklarata ime e dhënë agjencisë të lajmeve "Kosovapress" me datë 15 Shtator 2020, lidhur me ndikimin e pandemisë në afarizmin e ndërmarrjes NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë është keqinterpretuar dhe keqkuptuar nga publiku! Lidhur me këtë rast e jap një sqarim shtesë për opinionin e gjerë:

Në planifikimin e vitit 2020, pritshmëria e menaxhmentit të ndërmarrjes ka qenë që pas masave të ndërmarrura nga Menaxhmenti përmes uljes së shpenzimeve si atyre administrative dhe operacionale dhe rritjes së inkasimit më në fund të jetë me një fitim në afarizmin e saj, bazuar në vitin paraprak. Edhe pse fillimi i vitit ka qenë shumë premtues sepse të hyrat nga shërbimi i peronizimit si shërbim kryesor që krijon të hyrat kryesore në ndërmarrje gjatë muajve janar dhe shkurt ka qenë më i lartë se planifikimi për 13%, pandemia ka ndikuar që ky planifikim të mos realizohet pasi që ndërmarrja jonë ishte jofunksionale për afër 3 muaj pas masave të Qeverisë së Kosovës.

"Humbja" e apostrofuar në artikullin si dhe në intervistën e sipërpërmendur nuk korrespondon me realitetin financiar të ndërmarrjes sepse, në pasqyrat financiare të ndërmarrjes deri me datë 31.08.2020, pasqyrohet një afarizëm i suksesshëm, i cili është rezultat i masave të ndërmarrura nga Bordi dhe Menaxhmenti i Ndërmarrjes, i cili përkundër këtyre vështirësive po arrin që me sukses të tejkalojë problemet të cilat janë krijuar shkak i pandemisë. Në brenda një periudhe të shkurtër pas lehtësimit të masave kemi arrit një stabilitet financiar dhe nëse në muajt e ardhshëm nuk do të ketë masa shtrënguese për shkak të pandemisë jemi të sigurt për një realizim pozitiv financiar të ndërmarrjes tonë.

Sinqerisht,

Luan Hoti  
Kreyshef Ekzekutiv  
NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë